






BASHKIA
MIRDITË

RAPORTI I PERFORMANCËS 2024



Ky botim u mbështet nga 'Bashki të Forta', projekt i Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim SDC dhe Qeverisë së Suedisë, i zbatuar nga Helvetas. Pikëpamjet e shprehura në këtë botim nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht qëndrimet e Qeverisë së Zvicrës apo të Suedisë.



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Swiss Agency for Development
and Cooperation SDC



Sweden
Sverige



HELVETAS

Fjalor Shpjegues	4
Qëllimi i Raportit	8
Vështrim i Përgjithshëm mbi Bashkinë	8
Të Dhënat e Përgjithshme të Bashkisë	10
SHËRBIME PUBLIKE VENDORE	11
 Arsimi Parauniversitar	11
 Menaxhimi i Mbetjeve	14
 Mbrojtja nga zjarri	16
 Menaxhimi i infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit	17
 Administrimi i pyjeve dhe kullotave	18
 Mbrojtja Sociale	19
QEVERISJA E MIRË	22
 Burimet Njerëzore	22
 Transparenca	25
 Barazia Gjinore	27
Integrimi në BE	29
MENAXHIMI FINANCIAR	31
Përfundime dhe Rekomandime	Error! Bookmark not defined.

FJALOR SHPJEGUES

Disagregim

Është procesi i ndarjes së të dhënave sipas kategorive të veçanta (si gjinia, mosha, vendbanimi urban/rural, tipi i institucionit publik/privat etj.) me qëllim që të kuptohet më mirë shpërndarja dhe ndikimi i një shërbimi ose fenomeni. Disagregimi ndihmon për të vënë në pah pabarazitë, për të krahasuar grupet e ndryshme dhe për të planifikuar politika apo ndërhyrje më të orientuara dhe gjithëpërfshirëse.

Funksion

Është fusha e veprimtarisë, për të cilën njësia e vetëqeverisjes vendore është përgjegjëse dhe ka kompetencën ligjore për ta ushtruar lirisht, tërësisht apo në një pjesë të tij, në përputhje me ligjet dhe aktet nënligjore në fuqi.

Nën-Tregues

Një nën-tregues është një element më i detajuar i një treguesi kryesor, që shërben për ta shpërbërë dhe matur më saktësisht një aspekt të veçantë të tij. Nën-treguesit ndihmojnë në kuptimin më të thelluar të performancës, duke dhënë informacion të ndarë sipas gjinive, zonave gjeografike, llojit të shërbimit (publik/privat) apo kriterëve të tjera të disagregimit.

Produkt

Një produkt i realizuar nga bashkia i referohet një të mire materiale ose shërbimi që ofrohet nga bashkia, e cila është përgjegjëse për ofrimin e shërbimit apo të mirës materiale. Bashkitë sipas ligjit janë përgjegjëse për ofrimin e një game të gjerë shërbimesh publike, si transporti, kanalizimi, furnizimi me ujë, menaxhimi i mbetjeve, shërbimet e mbrojtjes nga zjarri dhe asaj civile, etj.

Qeverisja e Mirë

I referohet parimeve dhe praktikave që garantojnë funksionimin efikas, transparent, gjithëpërfshirës dhe të drejtë të një bashkie. Në këtë kuadër përfshihen elementë si transparenca publike, barazia gjinore, integriteti në BE, pjesëmarrja qytetare, profesionalizmi i burimeve njerëzore dhe menaxhimi i qëndrueshëm financiar.

Sistemi i Matjes së Performancës

Është mekanizmi kombëtar dhe vendor për mbledhjen, përpunimin dhe analizimin e të dhënave mbi ofrimin e shërbimeve nga bashkitë. Ky sistem përfshin një grup treguesish dhe nën-treguesish të standardizuar, që përdoren për të krahasuar performancën e bashkive, për të rritur transparencën, llogaridhënien dhe për të mbështetur vendimmarrjen e bazuar në të dhëna.

Bazuar në ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, neni 33, çdo bashki është e detyruar të krijojë një sistem të brendshëm matjeje dhe raportimi mbi performancën e saj, në lidhje me ofrimin e shërbimeve publike, përdorimin e burimeve dhe realizimin e objektivave. Ky sistem vendor lidhet ngushtë me sistemin kombëtar, duke mundësuar harmonizimin e të dhënave dhe krahasimin mes njërive të vetëqeverisjes vendore.

Shërbime Publike Vendore

Janë shërbimet që ofrohen nga bashkia për komunitetin, në përputhje me funksionet e përcaktuara nga ligji nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar. Këto përfshijnë, ndër të tjera, ndriçimin publik, arsimin parashkollor dhe çerdhet, mbrojtjen sociale, menaxhimin e mbetjeve, pyjeve e kullotave dhe ujitjen dhe kullimin etj. Sipas përkufizimit të ligjit “janë ato shërbime me interes të përgjithshëm publik, të cilat ofrohen për komunitetin nga bashkitë, në mënyrë të vazhdueshme, me çmime të përballueshme, sipas standardeve minimale kombëtare, të përcaktuara me ligj apo me akte të tjera normative.

Tregues performance

Një tregues i performancës është një matje që përdoret për të vlerësuar suksesin ose përparimin e një procesi. Mund të përdoret për të gjurmuar arritjet kryesore të performancës, të tilla si performanca financiare, kënaqësia e klientit, produktiviteti i punonjësve ose efikasiteti operacional, ose buxhetor / financiar dhe për të përcaktuar nëse synimet ose objektivat po përmbushen. Treguesit e performancës përdoren shpesh në sektorin privat por edhe atë publik dhe organizata të tjera për të ndihmuar menaxherët të marrin vendime të informuara, të identifikojnë fushat që kanë nevojë për përmirësim dhe të masin performancën e përgjithshme të bashkisë.

Të Dhëna

Janë informacionet e mbledhura nga burime zyrtare të bashkisë ose institucione të tjera, që shërbejnë si bazë për llogaritjen e treguesve të performancës. Të dhënat mund të jenë numerike (statistika mbi popullsinë, buxhetin, shkollat etj.) ose cilësore (planifikime, raporte, dokumente strategjike) dhe janë të domosdoshme për analizën dhe raportimin e performancës.

Taksat e ndara

Janë taksa kombëtare që mblidhen nga qeveria qendrore dhe ndahen plotësisht ose pjesërisht me bashkitë.

Taksat vendore

Janë detyrime fiskale të bashkisë të cilat paguhet sipas parashikimeve ligjore dhe përcaktimeve të Këshillit Bashkiak.

Tarifat vendore

Janë detyrime që individët apo bizneset paguajnë kundrejt marrjes së një shërbimi të ofruar nga bashkia

Transfertat e kushtëzuara

Janë fonde që buxheti i shtetit i jep bashkisë për t'u përdorur vetëm për projekte të veçanta apo funksione të deleguara bashkisë

Transfertat e pakushtëzuara

Janë fonde që buxheti shtetit i jep bashkisë për t'u përdorur pa kushte, pa interes dhe pa të drejtë kthimi

Transferta e pakushtëzuar sektoriale

Janë fonde që buxheti i shtetit i jep bashkisë me kushtin për t'u përdorur vetëm për funksione specifike që bashkia i ka marrë me ligj të veçantë

Trashëgimi nga viti i kaluar

Janë fonde buxhetore të bashkisë të cilat nuk janë shpenzuar në mbyllje të vitit buxhetor të kaluar dhe mund të përdoren në vitin korrent buxhetor. Ato mund të jenë me destinacion dhe pa destinacion. Pavarësisht nga kjo, ato mund të përdoren gjatë vitit korrent me destinacion të përcaktuar (për ato projekte apo zëra buxhetorë specifikë për të cilat janë angazhuar gjatë vitit të kaluar por nuk kanë arritur të shpenzohen) apo pa destinacion (për çfarëdo zë apo projekt).

Si të lexojmë tabelën e performancës

Tabelat e treguesve në çdo fushë paraqesin ecurinë e treguesve të performancës për secilën fushë funksionale. Për çdo tregues jepen vlerat për dy vite, ndryshimi ndër vite, trendi, dhe semafori, të cilat ndihmojnë në interpretimin e rezultateve.

Kolona

Përshkrimi

Treguesi	Emri i treguesit që mat një aspekt të caktuar të performancës (p.sh. “Përqindja e konsultimeve publike të zhvilluara”).
Njësia matëse	Tregon mënyrën se si matet treguesi (p.sh. %, numër, ha, lekë/frymë).
Vlera 2023 / 2024	Tregojnë rezultatet e arritura për secilin vit.
Ndryshimi (%)	Diferenca në përqindje ndërmjet viteve. Formula: $(\text{Vlera 2024} - \text{Vlera 2023}) / \text{Vlera 2023} \times 100$.
Trendi dhe Simboli i Trendit (→ ↑ ↓)	Diferenca në vlerë absolute ndërmjet viteve. (Vlera 2024 – Vlera 2023). Simboli i Trendit tregon drejtimin e lëvizjes: ↑ përmirësim, ↓ përkeqësim, → stabilitet
Semafori	Vlerësim vizual i nivelit të performancës: □ = vlerë absolute ndryshimi pozitiv ● = vlerë absolute ndryshimi negativ. □ = nuk ka ndryshim (vlera mbetet e njëjtë) ○ = mungojnë të dhënat (nuk raportohen vlera për një ose të dy vitet).

Nota metodologjike mbi semaforin dhe interpretimin e treguesve

Në tabelat e performancës, ngjyra e semaforit llogaritet automatikisht sipas parimit të përgjithshëm “vlera pozitive ndryshimi = jeshile”. Kjo rregull zbatohet njëtrajtësisht për të gjithë treguesit dhe mund të japë vizualisht ngjyrë të kuqe edhe në raste kur rezultati real është pozitiv. Në veçanti, për disa tregues me logjikë të përmbysur, ulja e vlerës absolute përfaqëson përmirësim të performancës.

Këtu përfshihen, ndër të tjera:

- Detyrimet e prapambetura (rënia tregon përmirësim financiar).
- Shpenzimet administrative (ulja tregon efikasitet).

QËLLIMI I RAPORTIT

Raporti i Performancës 2024 synon të ofrojë një pasqyrë të qartë dhe të strukturuar mbi performancën e bashkisë në 11 fusha funksionale për vitet 2023-2024 : arsimi parauniversitar, menaxhimi i infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit, administrimi i pyjeve dhe kullotave, menaxhimi i mbetjeve, mbrojtja nga zjarri, mbrojtja sociale, burimet njerëzore, transparencë, barazia gjinore, integrimi në BE, menaxhimi financiar. Ky raport përdoret për të ndihmuar vendimmarrjen e bazuar

në të dhëna, për të forcuar transparencën dhe llogaridhënien, si dhe për të mundësuar krahasimin ndërmjet bashkive në nivel kombëtar.

Ky raport është përgatitur nga Bashkia Mirditë dhe i miratuar nga Kryetari i Bashkisë në përputhje me Ligjin nr. 139/2015, Neni 33, si dhe në kuadër të Sistemit Kombëtar të Matjes së Performancës (SMP 2025).

VËSHTRIM I PËRGJITHSHËM MBI BASHKINË

Bashkia Mirditë kufizohet në veri, me bashkinë Pukë dhe Fushë Arrës, në perëndim me bashkinë Lezhë, në lindje me bashkinë Kukës dhe Dibër, ndërsa në jug me bashkitë Mat dhe Kurbin. Qendra e kësaj bashkie është qyteti Rrëshen, përbëhet nga 7 Njësi Administrative: Rrëshen, Rubik, Fanë, Orosh, Kthellë, Selitë dhe Kaçinar me sipërfaqe prej 867 km². Popullsia e bashkisë numëron rreth 36 mijë banorë sipas të dhënave të Regjistrit Civil, me një densitet 41.63, banor për km².

E veçantë për këtë bashki është ekzistenca e sipërfaqeve të konsiderueshme pyjore, burimet minerare dhe malet e larta si Munella, Zepa, Fushë-Lugje, Kunora etj, mjaft atraktive për turistët, vendas dhe të huaj.

Bashkia ka vendburime minerare mjaft të njohura dhe me rezerva të konsiderueshme në minerale të bakrit, piritit dhe metale të tjera. Ndër vendburimet me kryesoret janë : Spaçi, Rubiku, Kurbneshi, Perlati, Kaçinari etj. Aktualisht operator ekonomik të huaj kanë investuar dhe po punojnë në nxjerrjen dhe përpunimin e mineralit të bakrit në Spaç, në fazë studim kërkime në Perlat etj.

Në territorin e kësaj bashkie ka burime hidrike të konsiderueshme, ku peshën kryesore e zënë dy lumenj, Fani i Madh dhe Fani i Vogël . Operator ekonomik vendas dhe të huaj kanë investuar dhe po përdorin këto burime hidrike duke mundësuar vende pune dhe gjenerim të ardhura për ekonomine në këtë bashki.

Bashkia në bashkpunim me operator të ndryshëm ekonomik ka një vëmendje të shtuar në lidhje me turizmin malor. Hapja e bujtinave dhe shërbimi kryesisht me produkte ushqimore të prodhuara në këto zona, promovimi i tyre edhe nga bashkia, ka në fokus interesin e turizmit vendas dhe atë të huaj.

Disa nga sfidat kryesore të zhvillimit janë:

🏠 Mungesa ose cilësia e ulët e infrastrukturës rrugore, kryesisht në zonat rurale dhe ato turistike. Mungesa e mjeteve financiare për mirëmbajtjen dhe zgjerimin e infrastrukturës rrugore.

🏠 Mbarështimi i pyjeve dhe fondet e pamjaftueshme për investime në këtë sektor shumë të rëndësishëm për ekonominë e zonës.

🏘 Rivitalizimi i zonave historike, trashëgimisë kulturore dhe kujtesës.

🏘 Shpopullimi është një sfidë tjetër, që kryesisht lidhet me pamundësinë ekonomike.

🏘 Mungesa e fuqisë punëtore, e cila ka si shkak kryesor shpopullimin.

Duke marrë në konsideratë burimet e rëndësishme natyrore që disponon Mirdita — si mineralet, pyjet, burimet hidrike dhe potenciali i lartë turistik — konstatohet një situatë paradoksale, ku pavarësisht pasurive të konsiderueshme natyrore, zona përballet me mungesë të fondeve dhe me shpopullim të vazhdueshëm, i cili vjen si pasojë e pamundësisë ekonomike për të siguruar kushte të qëndrueshme jetese.

Në këtë kontekst, një strategji zhvillimore, veçanërisht në nivel rajonal dhe kombëtar, që synon rishpërndarjen e të ardhurave të gjeneruara nga këto resurse — të shfrytëzuara aktualisht nga operatorë ekonomikë koncesionarë — do të përbënte një zgjidhje themelore dhe afatgjatë për adresimin e këtyre sfidave kryesore zhvillimore të zonës.

TË DHËNAT E PËRGJITHSHME TË BASHKISË

E DHËNA

Viti 2024

Popullsia totale në administrimin e bashkisë

36094

Popullsia në qytet	11 101
Popullsia në njësitë administrative	24993
Sipërfaqja totale e bashkisë (në km2)	867
Sipërfaqe publike e bashkisë në km2	73
Sipërfaqja e njësive administrative në total	794
Sipërfaqe totale e fondit pyjor (në ha)	71100
Sipërfaqe totale e fondit kullosor (në ha)	2100
Sipërfaqja e tokës bujqësore (në ha)	6230
Numri total i njësive administrative të bashkisë	7
Numri i fshatrave	84
Punonjës të bashkisë në total	471
Numri total i punonjësve femra të bashkisë	83
Numri total i punonjësve meshkuj të bashkisë	388
Numri total i punonjësve që punojnë për administratën e bashkisë	60
Numri total i punonjësve femra që punojnë për administratën e bashkisë	31

SHËRBIME PUBLIKE VENDORE

Ky kapitull paraqet performancën e bashkisë në ofrimin e shërbimeve publike vendore, të cilat përbëjnë thelbin e përgjegjësisë të saj sipas ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar. Në këtë seksion, janë trajtuar gjashtë fusha kryesore të aprovuara edhe në kuadër të raportit kombëtar të performancës bashkiake, që përfshijnë gjithsej 10 funksione: arsimi parauniversitar (duke përfshirë çerdhet, arsimi parashkollor dhe infrastruktura e godinave

arsimore), ujitja dhe kullimi, administrimi i pyjeve dhe kullotave, menaxhimi i mbetjeve, mbrojtja nga zjarri, mbrojtja civile, si dhe mbrojtja sociale, e cila përfshin katër shërbime të detyrueshme sipas nenit 24 të ligjit.

Matja e performancës në këto fusha bazohet në tregues të standardizuar sipas SMP Kombëtar, tregues të tjerë vendorë që janë përzgjedhur nga bashkia, si dhe nën-tregues të detajuar, të cilët ofrojnë një pasqyrë të qartë mbi aksesin e qytetarëve në shërbime, cilësinë dhe kapacitetet e tyre, si dhe barazinë ndërmjet grupeve të ndryshme shoqërore. Përmes këtij sistemi, bashkia ka mundësi të identifikojë arritjet, sfidat e mbetura dhe nevojat për përmirësim në ofrimin e shërbimeve themelore për komunitetin.

ARSIMI PARAUNIVERSITAR

Përshkrim i përgjithshëm: Arsimi parauniversitar në nivel vendor përfshin shërbimet e arsimit të hershëm (çerdhe dhe kopshte), arsimin bazë 9-vjeçar dhe arsimin e mesëm të përgjithshëm. Kompetencat për administrimin dhe zhvillimin e këtij sektori janë të deleguara te njësitë e vetëqeverisjes vendore sipas ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar. Dy funksionet kryesore që rregullojnë këtë fushë janë:

- Funksioni 23.11: “Ndërtimin, rehabilitimin dhe mirëmbajtjen e ndërtesave arsimore të sistemit shkollor parauniversitar, me përjashtim të shkollave profesionale.”

- Funksioni 23.12: “Administrimin dhe rregullimin e sistemit arsimor parashkollor në kopshte dhe çerdhe.”

Në këtë kuadër, bashkitë janë përgjegjëse njëkohësisht për aspektet infrastrukturore dhe menaxheriale të institucioneve arsimore nën juridiksionin e tyre.

Në këtë seksion janë monitoruar 5 tregues kryesorë dhe 12 nën-tregues, të cilët mbulojnë qasjen në arsim (regjistrimin në çerdhe dhe kopshte publike e private), cilësinë e shërbimit (raportin fëmijë–mësues) si dhe gjendjen e infrastrukturës arsimore.


Raporti përmbledhës për Arsimin Parauniversitar paraqet një tablo të ndërthurur për periudhën 2023–2024: disa tregues shënojnë përmirësime të lehta në përfshirjen e fëmijëve, ndërsa të tjerë pasqyrojnë stagnim ose tërheqje. “Shkalla e regjistrimit në çerdhe publike” ka rënë me 1.49 pikë përqindjeje (nga 33.98% në 32.49%), duke reflektuar një ulje rreth 4%, ndërsa “Shkalla e regjistrimit në kopshte publike dhe private” është rritur me 1.68 pikë përqindjeje (≈2%), çka tregon zgjerim modest të pjesëmarrjes në arsimin e hershëm. Bashkia nuk disponon një Plan Vendor të Arsimit Parauniversitar dhe numri i godinave arsimore publike e private ka mbetur i pandryshuar.

Në nivel nën-treguesish, vihet re një rënie e theksuar e regjistrimit të vajzave në çerdhe publike (-26%) dhe një rritje për djemtë (+9%), duke krijuar një diferencë gjinore në përfshirje. Në kopshte

Lloj	Emri	Njësia Matëse	Vlera 2023	Vlera 2024	Trendi	Simboli i trendit	Kategoria e trendit	Semaf or	% Ndryshimi
Tregues	Shkalla e regjistrimit në çerdhe publike	%	33.98	32.49	-1.49	↓	Përkeqësuar	●	-4%
Tregues	Shkalla e regjistrimit në kopshte publike dhe private	%	90.49	92.17	1.68	↑	Përmirësuar	●	2%
Tregues	Plani Vendor i Arsimit Parauniversitar	Po/Jo	0.00	0.00	0.00	→	Pa ndryshim	●	
Tregues	Godina Arsimore sipas nivelit arsimor	numër	40.00	40.00	0.00	→	Pa ndryshim	●	0%
Nen-tregues	Shkalla e regjistrimit të vajzave në çerdhe publike	%	28.46	21.05	-7.41	↓	Përkeqësuar	●	-26%
Nen-	Shkalla e regjistrimit të djemve	%	39.68	43.09	3.41	↑	Përmirësuar	●	9%

publike, si vajzat ashtu edhe djemtë regjistrojnë rritje të lehtë (rreth +3%). Ndërkohë, raporti fëmijë–mësues në kopshte publike është rritur me rreth 5%.

Të dhënat tregojnë se performanca e Bashkisë në arsimin parauniversitar ka elementë pozitivë, por edhe hapësira të qarta për përmirësim. Rritja e pjesëmarrjes në kopshte dëshmon një tendencë pozitive drejt zgjerimit të aksesit në arsimin e hershëm, edhe pse rënia e regjistrimeve në çerdhe dhe diferencat gjinore sinjalizojnë nevojën për politika më të synuara për vajzat dhe moshat më të vogla. Mungesa e Planit Vendor të Arsimit Parauniversitar sugjeron një boshllëk strategjik, por njëkohësisht paraqet një mundësi të rëndësishme për bashkinë që, përmes hartimit të tij, të orientojë investimet, të rrisë cilësinë e shërbimeve dhe të balancojë raportin fëmijë–mësues. Në tërësi, situata aktuale krijon terren të favorshëm për përmirësime të qëndrueshme, përmes planifikimit më të strukturuar dhe qasjes së synuar ndaj barazisë gjinore dhe zgjerimit të kapaciteteve.



Grafik 1. Shkalla e regjistrimit në kopshte dhe çerdhe

tregues	në çerdhe publike									
Nen-tregues	Shkalla e regjistrimit të vajzave në kopshte publike	%	81.50	84.02	2.52	↑	Përmirësuar	●	3%	
Nen-tregues	Shkalla e regjistrimit të djemve në kopshte publike	%	99.05	100.00	0.95	↑	Përmirësuar	●	1%	
Nen-tregues	Godina Arsimore publike sipas nivelit arsimor	numër	39.00	39.00	0.00	→	Pa ndryshim	●	0%	
Nen-tregues	Godina Arsimore private sipas nivelit arsimor	numër	1.00	1.00	0.00	→	Pa ndryshim	●	0%	
Nen-tregues	Shkalla e regjistrimit në kopshte publike	%	90.49	92.17	1.68	↑	Përmirësuar	●	2%	
Nen-tregues	Raporti fëmijë-mësues në kopshte publike	nxënës/mësues	8.24	8.69	0.45	↑	Përmirësuar	●	5%	
E dhëna							Vlera 2023	Vlera 2024	Njësia Matëse	
Numri i fëmijëve të moshës nga 6 muaj-3 vjeç në bashki							256.00	237.00	Numër	
Numri i fëmijëve të moshës 6 muaj - 3 vjeç të regjistruar në çerdhe publike							87.00	77.00	Numër	
Numri i fëmijëve të moshës nga 3–6 vjeç në bashki							410.00	396.00	Numër	
Numri i fëmijëve të moshës 3-6 vjeç që frekuentojnë kopshtet publike							371.00	365.00	Numër	
Numri i fëmijëve të moshës 3-6 vjeç që frekuentojnë kopshtet private							0.00	0.00	Numër	
Numri i edukatorëve në kopshte publike							45.00	42.00	Numër	
Numri i edukatorëve në kopshte private							0.00	0.00	Numër	
Numri i çerdheve publike në bashki							2.00	2.00	Numër	
Numri i çerdheve private në bashki							0.00	0.00	Numër	
Numri i kopshteve publike në bashki							14.00	14.00	Numër	
Numri i kopshteve private në bashki							0.00	0.00	Numër	
Numri i shkollave 9-vjeçare publike në bashki							18.00	18.00	Numër	
Numri i shkollave 9-vjeçare private në bashki							0.00	0.00	Numër	
Numri i shkollave të mesme të përgjithshme publike në bashki							5.00	5.00	Numër	
Numri i shkollave të mesme të përgjithshme private në bashki							1.00	1.00	Numër	
Plani vendor i Arsimit Parauniversitar, I miratuar ose zbatuar							0.00	0.00	Po/Jo	


Tabela 1. Lista e detajuar e të dhënave

楸 MENAXHIMI I MBETJEVE

Përshkrim i përgjithshëm: Bashkitë janë përgjegjëse për menaxhimin e mbetjeve urbane dhe mbrojtjen e mjedisit në territorin e tyre. Ky funksion përfshin të gjitha aspektet që lidhen me mbledhjen, largimin, transportin, trajtimin dhe depozitimin e mbetjeve, si dhe mirëmbajtjen e pastërtisë në hapësirat publike si rrugët, sheshet, tregjet dhe parqet. Nëpërmjet këtij funksioni, bashkitë sigurojnë krijimin dhe operimin e sistemeve vendore për menaxhimin e mbetjeve, duke

përfshirë strukturat teknike, logjistikën, kontraktimin e subjekteve private dhe kontrollin e zbatimit të standardeve mjedisore. Shembuj të aktiviteteve përfshijnë: Mbikëqyrjen dhe funksionimin e sistemeve për grumbullimin dhe trajtimin e mbetjeve; Pastrimin dhe mirëmbajtjen e hapësirave publike (rrugë, parqe, tregje, kopshte publike); Dhënien e granteve ose fondeve për investime në infrastrukturën e mbetjeve; Monitorimin e ndotjes dhe koordinimin me institucionet për mbrojtjen e mjedisit. Ky funksion rrjedh nga ligji nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, neni 23, i cili i njeh bashkive kompetencën për menaxhimin e shërbimeve publike vendore, përfshirë menaxhimin e mbetjeve urbane dhe mirëmbajtjen e pastërtisë publike.

Gjatë periudhës 2023–2024, Bashkia Mirditë ka shënuar një përmirësim të dukshëm në menaxhimin e mbetjeve, duke rritur mbulimin e popullsisë me shërbimin nga 66.07% në 67.26%, një progres që vjen kryesisht nga zgjerimi i mbulimit në zonat rurale, ku përfshirja u rrit me 7%. Sasia e mbetjeve të gjeneruara për banor është rritur lehtë (nga 136.37 kg në 141.24 kg). Një arritje shumë domethënëse është rritja e mbulimit të kostos së shërbimit nga tarifa, nga 30.95% në 51.69% (67%), duke reflektuar një sistem financiarisht më të qëndrueshëm dhe më afër parimit të vetëfinancimit. Plani Vendor i Menaxhimit të Mbetjeve mbetet në fuqi edhe në vitin 2024, duke siguruar vazhdimësi të qasjes së planifikuar dhe strukturave funksionale. Në tërësi, progresi i vitit 2024 tregon se bashkia po forcon kapacitetet e saj, veçanërisht në zonat rurale, dhe po ndërton një sistem më efikas, më të qëndrueshëm dhe më të standardizuar të menaxhimit të mbetjeve.



Grafik 2. Mbulimi i popullsisë me shërbimin e menaxhimit të mbetjeve në zonat urbane/rurale

Tabela 2. Lista e detajuar e të dhënave

Lloj	Emri	Njësia Matëse	Vlera 2023	Vlera 2024	Trendi	Simbol i i trendit	Kategoria e trendit	Semaf or	% Ndryshimi
Tregues	Mbulimi i popullsisë me shërbimin e menaxhimit të mbetjeve në zonat urbane/rurale	%	66.07	67.26	1.19	↑	Përmirësuar	●	2%
Tregues	Mbetjet e gjeneruara si kg/banor	Kg /banor	136.37	141.24	4.87	↑	Përmirësuar	●	4%
Tregues	Mbulimi i kostos së menaxhimit të mbetjeve nga tarifa e shërbimit	%	30.95	51.69	20.74	↑	Përmirësuar	●	67%

Tregues	Plani vendor I menaxhimit të mbetjeve I miratuar ose në zbatim	Numër	1.00	1.00	0.00	→	Pa ndryshim	●	0%
Nen-tregues	Mbulimi i popullsisë me shërbimin e menaxhimit të mbetjeve në zonat urbane	%	100.00	100.00	0.00	→	Pa ndryshim	●	0%
Nen-tregues	Mbulimi i popullsisë me shërbimin e menaxhimit të mbetjeve në zonat rurale	%	33.33	35.80	2.47	↑	Përmirësuar	●	7%

E dhëna	Vlera 2023	Vlera 2024	Njësia Matëse
Numri njësive administrative qendër (qytete) të mbuluar me shërbimin e mbetjeve	1.00	1.00	Numër
Numri njësive administrative qendër (qytete) të bashkisë	1.00	1.00	Numër
Numri fshatrave të mbuluar me shërbimin e mbetjeve	27.00	29.00	Numër
Numri fshatrave në territorin e bashkisë	84.00	84.00	Numër
Sasia e mbetjeve të gjeneruara gjithsej	5098000.00	5098000.00	Kg
Të ardhurat gjithsej nga tarifa e shërbimit të mbetjeve	8914688.00	14887744.00	mijë Lekë
Shpenzime gjithsej për ofrimin e shërbimit të menaxhimit të mbetjeve	28800000.00	28800000.00	mijë Lekë
Plani i miratuar ose zbatuar gjatë vitit të raportimit	1.00	1.00	(Po/Jo)
Popullsia e përgjithshme e bashkisë	37384.00	36094.00	Numër

MBROJTJA NGA ZJARRI

Përshkrim i përgjithshëm: Bashkitë kanë përgjegjësi për garantimin e shërbimit zjarrfikës në nivel vendor dhe për administrimin e strukturave përkatëse të parandalimit dhe mbrojtjes kundër zjarrit. Ky funksion synon të sigurojë reagim të shpejtë dhe efektiv në raste emergjencash, si dhe të ndërtojë kapacitete vendore për parandalimin e zjarreve në mjedise urbane, rurale dhe pyjore. Përgjegjësitë e bashkive përfshijnë operimin dhe mirëmbajtjen e njësive zjarrfikëse, organizimin e shërbimeve parandaluese, si dhe bashkëpunimin me strukturat qendrore për raste që tejkalojnë kapacitetet vendore. Bashkitë gjithashtu angazhohen në edukimin e komunitetit dhe trajnimin e stafit për reagim dhe menaxhim të rreziqeve nga zjarret. Aktivitete përfaqësuese përfshijnë : Funksionimi dhe pajisja e njësive zjarrfikëse dhe shërbimeve të emergjencës; Zbatimi i masave të parandalimit në ndërtesa publike dhe hapësira komunitare; Trajnimi i stafit vendor dhe vullnetarëve për ndërhyrje dhe evakuim; Mbështetja e fushatave sensibilizuese për komunitetin në lidhje me rreziqet nga zjarri.

Gjatë periudhës 2023–2024, Bashkia Mirditë ka shënuar një përmirësim të lehtë, por domethënës, në kapacitetet e shërbimit zjarrfikës, duke reflektuar rritje të qëndrueshme të gatishmërisë operacionale dhe forcim të sigurisë komunitare. Numri i zjarrfikësve për 1,500 banorë është rritur nga 0.56 në 0.58 (4%), duke treguar shtim të burimeve njerëzore dhe përforcim

Kategoria	Vlera 2023	Vlera 2024
Automjete zjarrëfikëse për 10,000 banorë	0.80	0.83
Zjarrëfikës për 1,500 banorë	0.56	0.58

Tabela 3. Lista e detajuar e të dhënave


Lloj	Emri	Njësia Matëse	Vlera 2023	Vlera 2024	Trendi	Simboli i trendit	Kategoria e trendit	Semafor	% Ndryshimi
Tregues	Zjarrëfikës për 1,500 banorë	punonjës/1500 banorë	0.56	0.58	0.02	↑	Përmirësuar	●	4%
Tregues	Automjete zjarrëfikëse për 10,000 banorë	mjete/10000 banorë	0.80	0.83	0.03	↑	Përmirësuar	●	4%

E dhëna	Vlera 2023	Vlera 2024	Njësia Matëse
Numri i punonjësve zjarrëfikës në bashki	14.00	14.00	Numër
Popullsia e përgjithshme e bashkisë	37384.00	36094.00	Numër
Numri i mjeteve zjarrëfikëse funksionale në bashki	3.00	3.00	Numër

16

Përshkrim i përgjithshëm: Funkzioni për mirëmbajtjen e infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit është pjesë e kompetencave të deleguara të NJVV-të sipas ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, konkretisht neni 27 pika 1. Ky funksion përfshin ndërtimin, administrimin dhe mirëmbajtjen e sistemeve të ujitjes dhe kullimit në territorin e bashkisë, si dhe përgatitjen e planeve vendore për menaxhimin e qëndrueshëm të rrjeteve përkatëse. Qëllimi i këtij funksioni është mbështetja e zhvillimit të qëndrueshëm të prodhimit bujqësor dhe mbrojtja e konsumatorëve përmes garantimit të furnizimit me ujë për vaditje dhe menaxhimin të ujërave të tepërta në zonat bujqësore.

Raporti përmbledhës për ujitjen dhe kullimin tregon një stabilitet të përgjithshëm në performancën e treguesve për periudhën 2023–2024, me një përmirësim të lehtë në efikasitetin e kanaleve ujitëse. Treguesi kryesor “Toka bujqësore e pajisur me kanale ujitje/kullimi” ka mbetur i pandryshuar në nivelin 16.85%, duke treguar se sipërfaqja e tokës së mbuluar nga infrastruktura e ujitjes dhe kullimit nuk ka pësuar zgjerim gjatë periudhës së raportimit. Ndërkohë, treguesi “Përqindja e kanaleve ujitëse funksionale” ka shënuar një rritje të vogël prej 1.03 pikësh përqindjeje, nga 53.61% në 54.64%, që përkethehet në një përmirësim prej rreth 2%, duke reflektuar kujdes të shtuar në mirëmbajtjen ose rikthimin në funksion të kanaleve ekzistuese. Në tërësi, të dhënat tregojnë një situatë të qëndrueshme me përmirësime të vogla teknike, por që kërkon investime më të mëdha për zgjerimin e rrjetit të ujitjes dhe përmirësimin e plotë të funksionalitetit të sistemeve ekzistuese.



Grafik 4.Kanalet ujitëse funksionale

Tabela 4. Lista e detajuar e të dhënave

Lloj	Emri	Njësia Matëse	Vlera 2023	Vlera 2024	Trendi	Simboli i trendit	Kategoria e trendit	Semafor	% Ndryshimi
Tregues	Tokë bujqësore e pajisur me kanale ujitje/kullimi	%	16.85	16.85	0.00	→	Pa ndryshim	●	0%
Nen-tregues	Përqindja e kanaleve ujitëse funksionale	%	53.61	54.64	1.03	↑	Përmirësuar	●	2%

E dhëna	Vlera 2023	Vlera 2024	Njësia Matëse
Sipërfaqja gjithsej e tokës bujqësore në bashki	6230.00	6230.00	Hektarë
Sipërfaqja e tokës bujqësore e mbuluar me kanale ujitje dhe/ose kullimi	1050.00	1050.00	Hektarë
Gjatësia e kanaleve ujitëse	97.00	97.00	Kilometër (km)
Gjatësia e kanaleve ujitëse funksionale	52.00	53.00	Kilometër (km)
Gjatësia e kanaleve kulluese			Kilometër (km)
Gjatësia e kanaleve kulluese funksionale			Kilometër (km)

ADMINISTRIMI I PYJEVE DHE KULLOTAVE

Përshkrim i përgjithshëm : Funksioni i menaxhimit të pyjeve dhe kullotave, sipas nenit 27, pika 5 të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, i është deleguar bashkive me qëllim administrimin, mirëmbajtjen dhe zhvillimin e qëndrueshëm të fondit pyjor dhe kullor publik që ndodhet brenda territorit të NJVV-ve. Bashkitë janë përgjegjëse për hartimin dhe zbatimin e planeve të mbarështimit për fondet, monitorimin e tyre dhe për sigurimin e mbrojtjes kundër dëmtimeve, ndotjes apo zjarreve, në përputhje me legjislacionin për pyjet dhe kullotat.

Raporti përmbledhës për Pyjet dhe Kullotat tregon një stabilitet të plotë në të gjithë treguesit për periudhën 2023–2024, pa ndryshime të dukshme në asnjë prej vlerave të matura. Bashkia ka miratuar “Planin Vendor Mbarështimi. Edhe treguesi “Punonjës për 1,000 hektarë” ka mbetur konstant në 0.23, çka tregon se burimet njerëzore për administrimin e territorit pyjor nuk janë ndryshuar, duke ruajtur të njëjtën raport mes stafit dhe sipërfaqes së mbuluar. Në përgjithësi, të dhënat pasqyrojnë një situatë të qëndrueshme, ku nuk ka pasur zhvillime apo përkeqësime.

Tabela 5. Lista e detajuar e të dhënave

Lloj	Emri	Njësia Matëse	Vlera 2023	Vlera 2024	Trendi	Simboli i trendit	Kategoria e trendit	Semafor	% Ndryshimi
Tregues	Plan Vendor Mbarështimi I miratuar ose zbatuar	Cilësore (Po/Jo)	1.00	1.00	0.00	→	Pa ndryshim	●	0%
Tregues	Shkalla e pajisjes me plane mbarështimi	%	5.08	5.08	0.00	→	Pa ndryshim	●	0%
Tregues	Punonjës për 1,000 hektarë	punonjës/1000 ha	0.23	0.23	0.00	→	Pa ndryshim	●	0%

E dhëna	Vlera 2023	Vlera 2024	Njësia Matëse
Plan Vendor Mbarështimi I miratuar ose zbatuar	1.00	1.00	Cilësore (Po/Jo)

Sipërfaqja gjithsej e fondit pyjor dhe kullosor në bashki	61828.48	61828.48	Hektarë
Sipërfaqja e fondit pyjor dhe kullosor e mbuluar me plan mbarështimi	3140.00	3140.00	Hektarë
Numri i punonjësve për menaxhimin e fondit pyjor dhe kullosor	14.00	14.00	Numër

MBROJTJA SOCIALE

Përshkrim i përgjithshëm: Bashkitë janë përgjegjëse për krijimin, administrimin dhe ofrimin e shërbimeve sociale vendore për individët dhe familjet në nevojë, duke përfshirë personat me aftësi të kufizuara, fëmijët pa përkujdesje prindërore, të moshuarit, viktimat e dhunës dhe trafikimit, si dhe grupet e tjera vulnerabël. Shërbimet përfshijnë ndihma financiare dhe në natyrë, mbështetje për strehim dhe përfshirje sociale, si dhe funksionimin e qendrave ditore apo rezidenciale. Qëllimi i tyre është të lehtësojnë jetesën dhe të nxisin integrimin e qytetarëve në komunitet. Ndër shërbimet kryesore përfshihen: pagesat për kujdestari dhe lindje, ndihma për energji dhe nevoja bazë, shërbime për familjet me fëmijë me aftësi të kufizuara, mbështetje në kushte emergjente, strehim të përkohshëm dhe përkujdesje në shtëpi, si dhe masa për riintegrimin e të papunëve në tregun e punës. Bashkitë gjithashtu bashkëpunojnë me organizata jo fitimprurëse (OJF) dhe sektorin privat për ofrimin e këtyre shërbimeve në territor.

Raporti përmbledhës mbi shërbimet sociale dhe mbështetjen për grupet në nevojë tregon një tablo kryesisht pozitive dhe të qëndrueshme midis viteve 2023 dhe 2024, me disa përmirësime të lehta në disa tregues kyç dhe ndryshime të vogla në nivelet e nën-treguesve. Përqindja e familjeve që marrin ndihmë ekonomike është rritur lehtë nga 95.65% në 96.05%, duke treguar një rritje minimale por të qëndrueshme të mbulimit social, ndërsa shkalla e miratimit të strehimit social ka mbetur 100%, pa ndryshime. Një përmirësim modest vërehet në numrin e qendrave sociale komunitare publike, që është rritur nga 0.80 në 0.83 për 10,000 banorë, duke reflektuar zgjerim të lehtë të infrastrukturës sociale. Ndër treguesit më të rëndësishëm, përqindja e personave me aftësi të kufizuara që marrin mbështetje të integruar sociale është rritur nga 96.79% në 98.33%, me një rritje prej 2%, duke sinjalizuar forcim të përfshirjes sociale për këtë grup vulnerabël. Nga ana tjetër, përqindja e rasteve të referuara nga mekanizmi i koordinuar i referimit (MKR) që përfitojnë shërbime sociale ka mbetur e pandryshuar në 100%, që tregon ruajtje të performancës së lartë në këtë aspekt.

Në nivel nën-treguesish, grupmosha 30–44 vjeç ka shënuar një rritje prej 50%, ndërsa për disa grupmosha dhe kategori gjinore mungojnë të dhëna të plota, duke krijuar një pamje të pjesshme të ndryshimeve. Ndërkohë, personat me aftësi të kufizuara 18+ vjeç kanë pasur një rritje të lehtë prej 2%, dhe femrat me aftësi të kufizuara një përmirësim prej 3%, në kontrast me rënien e vogël (-3%) për grupmoshën 0–17 vjeç. Në tërësi, të dhënat tregojnë një trend pozitiv në ofrimin e mbështetjes sociale dhe përfshirjen e personave me aftësi të kufizuara, megjithëse nevojitet përmirësim në mbledhjen e të dhënave për grupmosha specifike dhe thellim i programeve për të rinjtë dhe zonat me mungesë të shërbimeve sociale.




Tabela 6. Lista e detajuar e të dhënave

Lloj	Emri	Njësia Matëse	Vlera 2023	Vlera 2024	Trendi	Simboli i trendit	Kategori a e trendit	Semafo r	% Ndryshimi
Tregues	Përqindja e familjeve që marrin ndihmë ekonomike	%	95.65	96.05	0.40	↑	Përmirë suar	●	0%
Tregues	Shkalla e miratimit të strehimit social	%	100.00	100.00	0.00	→	Pa ndryshi m	●	0%
Tregues	Numri i qendrave sociale komunitare publike, te licensuara për 10,000 banorë	qendra/ 10,000 banore	0.80	0.83	0.03	↑	Përmirë suar	●	4%
Tregues	Përqindja e rasteve të referuara nga mekanizmi i koordinuar i referimit (mkr) që përfitojnë shërbime sociale	%	100.00	100.00	0.00	→	Pa ndryshi m	●	0%
Tregues	Përqindja e personave me aftësi të kufizuar, të referuar nga komisionet bio-psiko-sociale që marrin mbështetje sociale të integruara	%	96.79	98.33	1.55	↑	Përmirë suar	●	2%
Tregues	Plan vendor social	Cilësore (Po/Jo)	1.00	1.00	0.00	→	Pa ndryshi m	●	0%
Nen-tregues	Përqindja e meshkujve me aftësi të kufizuar, të referuar nga komisionet bio-psiko-sociale që marrin mbështetje	%	98.25	98.52	0.27	↑	Përmirë suar	●	0%

	sociale të integruara								
Nen-tregues	Përqindja e personave grupmosha 0-17 vjeç me aftësi të kufizuar, të referuar nga komisionet bio-psiko-sociale që marrin mbështetje sociale të integruara	%	97.33	94.44	-2.89	↓	Përkeqësuar	●	-3%
Nen-tregues	Përqindja e personave grupmosha 18+ vjeç me aftësi të kufizuar, të referuar nga komisionet bio-psiko-sociale që marrin mbështetje sociale të integruara	%	96.70	98.93	2.23	↑	Përmirësuar	●	2%

E dhëna	Vlera 2023	Vlera 2024	Njësia Matëse
Numri i familjeve që kanë aplikuar për ndihmë ekonomike	735.00	658.00	Numër
Numri i familjeve përfituese të ndihmës ekonomike	703.00	632.00	Numër
Popullsia e përgjithshme e bashkisë	37384.00	36094.00	Numër
Numri i personave që kanë paraqitur kërkesë për strehim social	107.00	162.00	Numër
Numri i personave përfitues të strehimit social	107.00	162.00	Numër
Numri i qendrave sociale ditore funksionale	3.00	3.00	Numër
Numri i qendrave sociale rezidenciale funksionale	0.00	0.00	Numër
Numri i rasteve të dhunës në familje dhe formave të tjera të dhunës të referuara nga Mekanizmit i Koordinuar i Referimit	3.00	4.00	Numër
Numri i rasteve të dhunës në familje dhe formave të tjera të dhunës të referuara nga antarët e Mekanizmit të Koordinuar të Referimit (MKR), të cilat kanë përfituar shërbime sociale	3.00	4.00	Numër
Numri i PAK të referuar nga shërbimet bio-psiko-sociale për të marrë shërbime sociale	560.00	540.00	Numër
Numri i PAK që marrin mbështetje si pasojë e referimit	542.00	531.00	Numër
Plani Vendor Social, i miratuar apo zbatuargjatë periudhës së raportimit	1.00	1.00	Cilesore(Po=1/Jo=0)


QEVERISJA E MIRE

瘡 BURIMET NJERËZORE

Përshkrim i përgjithshëm: Bashkitë kanë rol të rëndësishëm në menaxhimin e burimeve njerëzore për administratën vendore dhe strukturat e varësisë. Ky funksion përfshin planifikimin, organizimin dhe zhvillimin e kapaciteteve të stafit, si dhe ndjekjen e dinamikave të personelit, përfshirë rekrutimin, rotacionin, trajnimin dhe raportimin vjetor të të dhënave mbi stafin aktiv dhe të larguar. Qëllimi është të sigurohet një trupë administrative efektive, e kualifikuar dhe në përputhje me nevojat e ofrimit të shërbimeve publike vendore. Përmes këtij funksioni, bashkia ndjek tregues si numri i punonjësve për 1,000 banorë, përqindja e stafit të trajnuar, si dhe lëvizjet vjetore të stafit sipas gjinisë dhe njësisë strukturore (administratë ose njësi shpenzuese).

Analiza e të dhënave për Burimet Njerëzore tregon një dinamikë të përzier midis viteve 2023 dhe 2024, ku disa tregues kanë pësuar përmirësime të moderuara, ndërsa të tjerë shënojnë rënie të dukshme, sidomos në lidhje me rotacionin e stafit. Treguesi “Shkalla e rotacionit të punonjësve të bashkisë” ka rënë nga 15.84% në 13.80%, një ulje prej 13%, që tregon stabilizim të pjesshëm të stafit. Në të kundërt, treguesi “Punonjës për 1,000 banorë” është rritur nga 11.82 në 13.05, një rritje prej 10%, që sugjeron forcim të kapaciteteve njerëzore në raport me popullsinë. Gjithashtu, përqindja e stafit të trajnuar është rritur lehtë me 0.05 pikë përqindjeje, ndërsa gratë e trajnuara kanë shënuar një rritje domethënëse prej 29%, në kontrast me rënien e trajnimeve për burrat me 30%. Ndërkohë, edhe stafi i administratës dhe ai i njësive shpenzuese kanë pasur përmirësime të vogla përkatësisht me 9% dhe 1%. Në përgjithësi, të dhënat tregojnë një rritje të kapaciteteve njerëzore dhe trajnuese, por edhe sfida të dukshme në balancimin gjinor të trajnimeve dhe në stabilitetin e strukturave administrative, që kërkojnë nënqendrim të politikave në zhvillim të qëndrueshëm të burimeve njerëzore në nivel vendor.

Grafik 6. Burimet Njerëzore



Burimet Njerëzore




Tabela 7. Lista e detajuar e të dhënave

Lloj	Emri	Njësia Matëse	Vlera 2023	Vlera 2024	Trendi	Simboli i trendit	Kategoria e trendit	Semafor	% Ndryshimi
Tregues	Shkalla e rotacionit të punonjësve të bashkisë	%	15.84	13.80	-2.04	↓			-13%
Tregues	Përqindja e stafit të punësuar nga bashkia të trajnuar	%	9.50	9.55	0.05	↑	Përmirësuar	●	1%
Tregues	Punonjës për 1000 banorë	Punonjës /1,000 banorë	11.82	13.05	1.23	↑	Përmirësuar	●	10%
Nen-tregues	Shkalla e rotacionit të punonjësve femra të bashkisë	%	11.50	8.53	-2.97	↓			-26%
Nen-tregues	Shkalla e rotacionit të punonjësve meshkuj të bashkisë	%	19.42	18.08	-1.34	↓			-7%
Nen-tregues	Shkalla e rotacionit të punonjësve të administratës të bashkisë	%	25.42	20.00	-5.42	↓			-21%
Nen-tregues	Shkalla e rotacionit të punonjësve të njësive shpenzuese të bashkisë	%	10.60	11.00	0.40	↑			4%
Nen-tregues	Përqindja e stafit femra të trajnuar	%	11.00	14.22	3.22	↑	Përmirësuar	●	29%

Nen-tregues	Përqindja e stafit meshkuj të trajnuar	%	8.26	5.77	-2.50	↓	Përkeqësuar	●	-30%
Nen-tregues	Përqindja e stafit të administratës të trajnuar	%	30.51	33.33	2.82	↑	Përmirësuar	●	9%
Nen-tregues	Përqindja e stafit të njësive shpenzuese të trajnuar	%	8.48	8.59	0.11	↑	Përmirësuar	●	1%

E dhëna	Vlera 2023	Vlera 2024	Njësia Matëse
Numri i punonjësve në bashki gjatë vitit të raportimit	442.00	471.00	Numër
Numri i punonjësve të larguar nga bashkia gjatë vitit të raportimit	70.00	65.00	Numër
Popullsia e përgjithshme e bashkisë	37384.00	36094.00	Numër
Numri i punonjësve të trajnuar gjatë vitit	42.00	45.00	Numër
Numri i punonjësve të shërbimeve të nënkontraktuara në bashki gjatë vitit të raportimit	0.00	0.00	Numër

TRANSPARENCA


Përshkrim i përgjithshëm : Transparenca dhe llogaridhënia janë elementë thelbësorë të qeverisjes së mirë në nivel vendor. Bashkia ka detyrimin të sigurojë pjesëmarrjen e qytetarëve në procesin vendimmarrës, të publikojë informacionin mbi veprimtarinë institucionale dhe të japi llogari për realizimin e detyrave të tyre. Këto parime përforcojnë besimin e publikut, përmirësojnë shërbimet dhe parandalojnë abuzimet me pushtetin. Në këtë kuadër, bashkia duhet të garantojë : (i) zhvillimin e konsultimeve publike për aktet me ndikim në komunitet ; (ii) publikimin e vendimeve të Këshillit Bashkiak dhe dokumenteve të rëndësishme si Plani Buxhetor Afatmesëm, Paketa Fiskale dhe raportet vjetore të transparencës ; (iii) hartimin dhe zbatimin e planeve të integritetit për të forcuar etikën institucionale.

Gjatë periudhës 2023–2024, performanca e bashkisë në fushën e transparencës dhe qeverisjes së hapur ka mbetur e qëndrueshme, me pak ndryshime në krahasim me një vit më parë. Të dhënat tregojnë se numri i akteve për të cilat është i detyrueshëm zhvillimi i konsultimit publik janë konsultuar, duke reflektuar vijimësi në zbatimin e detyrimeve ligjore për përfshirjen e qytetarëve dhe grupeve të interesit në proceset vendimmarrëse.

Gjithashtu, bashkia ka hartuar dhe publikuar “Raportin Vjetor për Transparencën në Procesin e Vendimmarrjes”, duke treguar angazhim për ruajtjen e standardeve të hapjes dhe llogaridhënies institucionale. Ky raport përbën një instrument të rëndësishëm për rritjen e besimit të publikut dhe vlerësimin e shkallës së transparencës në vendimmarrjen vendore.

Megjithatë, vihet re se “Plani Vendor i Integritetit” ende nuk është hartuar, çka përbën një boshllëk në kuadrin e instrumenteve të brendshme të kontrollit etik dhe parandalimit të korrupsionit. Hartimi i këtij plani mbetet i domosdoshëm për forcimin e integritetit institucional dhe përmirësimin e mekanizmave të qeverisjes së mirë në nivel lokal.

Në përfundim, transparenca institucionale e bashkisë gjatë kësaj periudhe vlerësohet e qëndrueshme, por kërkon përmirësime në komponentin e integritetit dhe menaxhimit etik, për të siguruar një qasje më gjithëpërfshirëse dhe të balancuar ndaj standardeve të qeverisjes së hapur.



Grafik 8. Lista e detajuar e të dhënave

Lloj	Emri	Njësia Matëse	Vlera 2023	Vlera 2024	Trendi	Simboli i trendit	Kategoria e trendit	Semafor	% Ndryshimi
Tregues	Akte për të cilët është i detyrueshëm zhvillimi i konsultimit publik	punonjës/1500 banorë	100.00	100.00	0.00	→	Pa ndryshim	●	0%
Tregues	Raporti vjetor për transparencën në procesin e vendimmarrjes	mjete/10000 banorë	1.00	1.00	0.00	→	Pa ndryshim	●	0%
Tregues	Plani Vendor i Integritetit		0.00	0.00	0.00	→	Pa ndryshim	●	
E dhëna						Vlera	Vlera	Njësia Matëse	

	2023	2024	
Numri i akteve gjithsej për të cilat është i detyrueshëm zhvillimi i konsultimit publik	3.00	3.00	Numër
Numri i akteve për të cilët është zhvilluar konsultimi publik	3.00	3.00	Numër
Publikimi i raportit vjetor për transparencën	1.00	1.00	Cilësore (Po=1/Jo=0)
Plani Vendor i Integritetit, i miratuar ose zbatuar gjatë periudhës së raportimit	0.00	0.00	Cilësore (Po=1/Jo=0)


BARAZIA GJINORE

Përshkrim i përgjithshëm: Barazia gjinore në qeverisjen vendore është një element kyç për ndërtimin e institucioneve demokratike, të përgjegjshme dhe gjithëpërfshirëse. Ajo nënkupton jo vetëm balancën në përfaqësim midis grave dhe burrave në pozicione drejtuese, por edhe integrimin sistematik të perspektivës gjinore në të gjitha proceset vendimmarrëse, politikat publike dhe ofrimin e shërbimeve. Në këtë kontekst, bashkitë duhet të garantojnë: • pjesëmarrje të barabartë gjinore në përputhje me legjislacionin në fuqi për barazinë gjinore, në strukturat vendimmarrëse dhe administrative; • buxhetim të përgjegjshëm gjinor (gender-responsive budgeting), sipas parashikimeve në legjislacionin në fuqi; • ofrim shërbimesh që adresojnë në mënyrë të barabartë nevojat e ndryshme të grave dhe burrave, vajzave dhe djemve; • mekanizma për mbrojtjen nga diskriminimi gjinor, diskriminimi për shkak të përkatësisë së shumëfishtë dhe dhuna me bazë gjinore. Bashkitë janë të detyruara të raportojnë jo vetëm për përfaqësimin gjinor në pozicione vendimmarrëse, por edhe për masat e marra për të zbatuar barazinë gjinore në praktikë, në përputhje me legjislacionin kombëtar dhe angazhimet ndërkombëtare.

Raporti për Barazinë Gjinore për periudhën 2023–2024 tregon një nivel të qëndrueshëm të performancës në të gjithë treguesit e monitoruar, duke reflektuar vazhdimësi institucionale dhe stabilitet në përfaqësimin e grave në strukturat drejtuese dhe vendimmarrëse të bashkisë. Treguesi “Përqindja e grave në pozicione si kryetare, zv.kryetare, anëtare të këshillit bashkiak dhe administratore” ka mbetur në nivelin 29.03%, duke ruajtur një prani të qëndrueshme të grave në qeverisjen vendore. Po ashtu, “Përqindja e grave në pozicione drejtuese të ndryshme

në bashki” ka mbetur në 25%, çka tregon se balanca gjinore në administratën vendore është e konsoliduar, megjithëse hapësirat për rritje mbeten të pranishme.

Ndërkohë, “Plani Vendor i Veprimit për Barazinë Gjinore” ende nuk është miratuar, por krijon një mundësi të rëndësishme për avancim në fazën e ardhshme, pasi miratimi dhe zbatimi i tij do të mundësojnë zhvillimin e politikave të integruara dhe të matshme për fuqizimin e grave dhe vajzave në nivel lokal. Në tërësi, performanca e qëndrueshme gjatë kësaj periudhe përbën një bazë solide për ndërmarrjen e veprimeve të reja për rritjen e përfaqësimit dhe promovimin e barazisë gjinore në proceset e vendimmarrjes vendore.



Grafik 8. Përfaqësimin e grave në strukturat drejtuese

Grafik 9. Lista e detajuar e të dhënave

Lloj	Emri	Njësia Matëse	Vlera 2023	Vlera 2024	Trendi	Simboli i trendit	Kategoria e trendit	Semafor	% Ndryshimi
Tregues	Përqindja e grave në pozicione: kryetare, zv.kryetare, anëtare në këshill bashkiak dhe administratore	%	29.03	29.03	0.00	→	Pa ndryshim	●	0%
Tregues	Përqindja e grave në pozicione drejtuese të ndryshme (të lartë, të mesme, të ulët) në bashki	%	25.00	25.00	0.00	→	Pa ndryshim	●	0%
Tregues	Plan Vendor Veprimi për Barazinë Gjinore	Cilësore (Po/Jo)	0.00	0.00	0.00	→	Pa ndryshim	●	

E dhëna	Vlera 2023	Vlera 2024	Njësia Matëse
---------	------------	------------	---------------

Numri gjithsej i pozicioneve drejtuese në bashki (Kryetare/Kryetar Bashkie, zv.Kryetare/zv.Kryetar Bashkie, Administratore/Administrator, Anëtare/Anëtarë në Këshill Bashkiak).	31.00	31.00	Numër
Numri i grave në pozicione drejtuese në bashki: Kryetare, zv.Kryetare, Anëtare në Këshill Bashkiak dhe Administratore	9.00	9.00	Numër
Numri i pozicioneve drejtuese të ndryshme (të lartë, të mesme, të ulët)	3.00	3.00	Numër
Numri i grave në pozicione drejtuese të ndryshme (të lartë, të mesme, të ulët)	12.00	12.00	Numër
Plan Vendor Veprimi për Barazinë Gjinore, i miratuar ose zbatuar gjatë periudhës së raportimit	0.00	0.00	Cilësore (Po/Jo).

INTEGRIMI NË BE

Përshkrim i përgjithshëm: Integrimi në Bashkimin Evropian nuk është vetëm një detyrë e qeverisjes qendrore, por një proces i përbashkët që përfshin të gjitha nivelet e administratës publike, edhe qeverisjen vendore. Bashkitë luajnë një rol kritik në përafrimin me *acquis communautaire* dhe përmbushjen e kriterëve të anëtarësimit, përmes politikave dhe shërbimeve që ndikojnë drejtpërdrejt në jetën e qytetarëve. Në këtë kuptim, bashkive u rekomandohet të:

- Ndërtojnë kapacitete administrative për të përthithur dhe zbatuar fondet e BE-së;
- Zhvillojnë plane vendore për përputhshmëri me politikat e BE-së në fusha si mjedisi, energjia, digjitalizimi, barazia gjinore, migracioni, zhvillimi rural dhe përfshirja sociale;
- Fuqizojnë rolin e komuniteteve në procesin e integrimit përmes transparencës, pjesëmarrjes dhe ndërtimit të besimit publik.

Raporti përmbledhës për Integrimin në Bashkimin Evropian tregon një situatë të qëndrueshme, duke reflektuar një përparim të kufizuar në disa fusha dhe një përkeqësim të lehtë në të tjera. Treguesi “Projekte të fituara kundrejt të aplikuara nga Bashkimi Evropian” ka pësuar një ulje prej 4.17 pikësh përqindjeje, nga 37.50% në 33.33%, që përfaqëson një rënie prej 11% dhe sinjalizon dobësim në performancën e bashkisë në sigurimin e fondeve evropiane. Ndërkohë, bashkia ka krijuar komisionet e integrimit evropian pranë këshillave bashkiakë. Nga ana tjetër, treguesi “Numri i marrëveshjeve ndërbashkiake të nënshkruara nga secila bashki” ka mbetur i pandryshuar në 0.00. Kjo sugjeron një mungesë të bashkëpunimeve horizontale ndërmjet njësive

vendore, të cilat mund të luanin një rol të rëndësishëm në shkëmbimin e praktikave të mira dhe zbatimin e projekteve të përbashkëta. Mungesa e një Plani të Migracionit dhe Diasporës përbën një boshllëk të rëndësishëm strategjik në qeverisjen vendore, pasi ky dokument ka rol kyç në menaxhimin e ndryshimeve demografike dhe në shfrytëzimin e potencialit zhvillimor të diasporës. Mungesa e “Ekzistencës dhe funksionimit të strukturave të performancës në bashki” tregon një boshllëk të rëndësishëm në menaxhimin e brendshëm institucional, pasi këto mekanizma janë thelbësorë për monitorimin sistematik të shërbimeve, matjen e rezultateve dhe orientimin e vendimmarrjes mbi bazë evidencash. Pa një strukturë funksionale të performancës, bashkia ka vështirësi të sigurojë llogaridhënie të brendshme, të identifikojë sektorët me mangësi, të planifikojë ndërhyrje dhe të përmirësojë cilësinë e shërbimeve publike.

Tabela 10. Lista e detajuar e të dhënave

Lloj	Totali	Të dy vitet	Jeshile	Portokalli	E kuqe	Gri	Performuesi më i mirë	Performuesi më i dobët
Tregues	5	3	0	2	1	2	Komisionet e integritetit evropian pranë këshillave bashkiakë ($\Delta=0$)	Projekte të fituara kundrejt të aplikuara nga bashkimi evropian (periudha 2-vjeçare 2023-2024) ($\Delta=-4.1666666666666714$)

Lloj	Emri	Njësia Matëse	Vlera 2023	Vlera 2024	Trendi	Simboli i trendit	Kategoria e trendit	Semafor	% Ndryshimi
Tregues	Numri i marrëveshjeve ndërbashkiake të nënshkruara nga secila bashki	Numër	0.00	0.00	0.00	→	Pa ndryshim	●	
Tregues	Ekzistenca dhe funksionimi i strukturave të performancës në bashki	Numër	0.00	0.00	0.00	→	Pa ndryshim	●	
Tregues	Projekte të fituara kundrejt të aplikuara nga bashkimi evropian (periudha 2-vjeçare 2023-2024)	%	37.50	33.33	-4.17	↓	Përkeqësuar	●	-11%
Tregues	Planet e migracionit dhe diasporës	Numër	0.00	0.00	0.00	→	Pa ndryshim	●	Numër
Tregues	Komisionet e integritetit evropian pranë këshillave bashkiakë	Cilësore (Po/Jo)	1.00	1.00	0.00	→	Pa ndryshim	●	0%

E dhëna	Vlera 2023	Vlera 2024	Njësia Matëse
Numri i marrëveshjeve ndërbashkiake të nënshkruara	0.00	0.00	Numër
Struktura e performancës e përfshirë në organizimin funksional të bashkisë	Bosh	1.00	Cilësore (Po=1/Jo=Bosh).

Strukturat e performancës ngritur pranë drejtorisë së Integrimit Evropian sipas manualeve orientuese të AMVV-së	Bosh	Bosh	Cilësore (Po=0/Jo=Bosh).
Numri i projekteve të BE që bashkia ka aplikuar gjatë periudhës së raportimit	8.00	3.00	Numër
Numri i projekteve të BE të fituara gjatë periudhës së raportimit	3.00	1.00	Numër
Plani Vendor i Migracionit dhe Diasporës, i miratuar apo zbatuar gjatë periudhës së raportimit	Bosh	Bosh	Cilësore (Po=0/Jo=Bosh).
Komisionet e Integrimit Evropian pranë Këshillave Bashkiakë	1.00	1.00	Cilësore (Po=0/Jo=Bosh).

MENAXHIMI FINANCIAR


Menaxhimi financiar është një funksion kyç për sigurimin e qëndrueshmërisë dhe eficiencës së qeverisjes vendore. Ai përfshin planifikimin, administrimin dhe raportimin e burimeve financiare të bashkisë, në përputhje me parimet e përgjegjshmërisë dhe transparencës. Në përmbushjen e këtij funksioni, bashkitë udhëhiqen nga kuadri ligjor për financat vendore, përfshirë ligjin nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” dhe ligjin nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”. Kjo kategori ndahet në tre fusha të veçanta që mbulojnë ciklin financiar: të ardhurat, shpenzimet, dhe buxheti. Vlerësimi i këtyre fushave ndihmon në monitorimin e kapaciteteve financiare të bashkive dhe në analizën e performancës së tyre në përdorimin dhe menaxhimin e burimeve publike.

Raporti përmbledhës për Të ardhurat për periudhën 2023–2024 tregon një përmirësim të dukshëm të performancës financiare të njësisë vendore, me rritje të ndjeshme në shumicën e treguesve ekonomikë, pavarësisht disa përkeqësimeve të lehta në efikasitetin e shpenzimeve. Të ardhurat e veta për frymë janë rritur me 34%, nga 1,697.33 lekë në 2,280.10 lekë, ndërsa raporti i të ardhurave të veta ndaj transfertave është përmirësuar me 13%, duke arritur në 17.29%, çka tregon rritje të autonomisë fiskale të bashkisë. Po ashtu, raporti i të ardhurave të veta ndaj buxhetit është rritur me 11%, dhe të ardhurat nga taksa e pasurisë kanë shënuar një rritje të theksuar prej 66%, duke u rritur nga 6.32% në 10.49%. Një tregues shumë pozitiv është buxheti i miratuar për frymë, i cili është rritur me 30% (nga 15,483.20 lekë në 20,122.65 lekë), si dhe investimet për frymë, që janë rritur me 76%, nga 974.24 në 1,715.49 lekë, duke reflektuar angazhim më të madh në zhvillimin lokal. Nga ana tjetër, shkalla e përdorimit të të ardhurave ka pësuar një ulje të ndjeshme prej 33%, duke rënë nga 164.08% në 109.65%. Po ashtu, përqindja e shpenzimeve operative është ulur me 7%, ndërsa pesha

e investimeve në buxhet ka shënuar një rënie të lehtë prej 3%, duke treguar rishpërndarje të shpenzimeve drejt kostove të personelit, që janë rritur me 2%. Në tërësi, viti 2024 paraqet një përmirësim të qartë në mbledhjen dhe menaxhimin e të ardhurave vendore, me një rritje të qëndrueshme të bazës fiskale, por edhe me nevojë për optimizim të mëtejshëm në përdorimin e burimeve financiare.

Tabela 11. Lista e detajuar e të dhënave

Lloj	Emri	Njësia Matëse	Vlera 2023	Vlera 2024	Trendi	Simboli i trendit	Kategoria e trendit	Semafor	% Ndryshimi
Tregues	Të ardhurat e veta për frymë	leke/person	1697.33	2280.10	582.77	↑	Përmirësuar	●	34%
Tregues	Të ardhurat e veta përkundrejt transfertave	%	15.28	17.29	2.01	↑	Përmirësuar	●	13%
Tregues	Raporti i të ardhurave të veta ndaj buxhetit	%	13.25	14.74	1.49	↑	Përmirësuar	●	11%
Tregues	Shkalla e përdorimit të të ardhurave	%	164.08	109.65	-54.43	↓	Përkeqësuar	●	-33%
Tregues	Të ardhurat nga taksa e pasurisë në raport me të ardhurat vendore	%	6.32	10.49	4.17	↑	Përmirësuar	●	66%
Tregues	Buxheti i miratuar për frymë	leke/person	15483.20	20122.65	4639.45	↑	Përmirësuar	●	30%
Tregues	Shkalla e ekzekutimit të buxhetit	%	50.41	70.10	19.68	↑	Përmirësuar	●	39%
Tregues	Investime për frymë	leke/person	974.24	1715.49	741.25	↑	Përmirësuar	●	76%
Tregues	Pesha e investimeve në buxhet	%	12.48	12.16	-0.32	↓	Përkeqësuar	●	-3%
Tregues	Pesha e detyrimeve financiare të papaguara ndaj të tretëve	%	0.00	0.00	0.00	→	Pa ndryshim	●	
Tregues	Pesha e personelit në buxhet	%	72.49	73.82	1.33	↑	Përmirësuar	●	2%
Tregues	Pesha e shpenzimeve operacionale në buxhet	%	15.03	14.02	-1.01	↓	Përkeqësuar	●	-7%



Grafik 9. Përfaqësimin e grave në strukturat drejtuese

E dhëna	Vlera 2023	Vlera 2024	Njësia Matëse
Të ardhurat e veta, fakt	63453.00	82298.00	Mijë Leke
Popullsia e përgjithshme e bashkisë	37384.00	36094.00	Numër
Transferrat gjithsej, fakt	415344.00	475951.00	Mijë Leke
Të ardhurat e përgjithshme, fakt	478797.00	558249.00	Mijë Leke
Totalit i shpenzimeve të bashkisë , fakt	291806.00	509117.00	Mijë Leke
Të ardhurat nga taksa e pasurisë, fakt	4008.00	8629.00	Mijë Leke
Shpenzime gjithsej, plan i rishikuar	578824.00	726307.00	Mijë Leke
Shpenzime kapitale, fakt	36421.00	61919.00	Mijë Leke
Detyrime të papaguara mbi 30 ditë	0.00	0.00	Mijë Leke
Shpenzime personeli, fakt	211524.00	375834.00	Mijë Leke
Shpenzime operacionale, fakt	43861.00	71364.00	Mijë Leke

PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME

Gjatë periudhës 2023–2024, Bashkia Mirditë ka bërë hapa të dukshëm përpara në forcimin e kapaciteteve të saj institucionale dhe në përmirësimin gradual të shërbimeve për qytetarët, duke reflektuar një qasje më të konsoliduar ndaj matjes së performancës dhe vendimmarrjes së bazuar në të dhëna.

Në fushën e shërbimeve publike vendore, vihet re progres në **menaxhimin e mbetjeve** (rritje e mbulimit të popullsisë, sidomos në zonat rurale, dhe rritje e ndjeshme e mbulimit të kostos nga tarifa), forcim i kapaciteteve të **shërbimit zjarfikës**, si dhe një situatë e qëndrueshme në mirëmbajtjen e **infrastrukturës së ujitjes dhe në administrimin e pyjeve e kullotave**, ku planet vendore të mbarështimit janë në fuqi dhe po sigurojnë vazhdimësi në menaxhim. Në **arsimin parauniversitar**, edhe pse ka sfida në regjistrimin në çerdhe dhe në balancat gjinore, ruhet një

nivel i mirë përfshirjeje në kopshte dhe ekziston potencial i qartë për përmirësim përmes planifikimit më të mirë strategjik.

Në fushën e **mbrojtjes sociale**, bashkia paraqet performancë pozitive dhe të qëndrueshme, me mbulim pothuajse të plotë të familjeve që marrin ndihmë ekonomike, shkallë 100% miratimi për strehimin social dhe rritje të mbështetjes së integruar për personat me aftësi të kufizuara, si për gra ashtu edhe për burra. Kjo tregon se rrjetet e mbrojtjes sociale funksionojnë dhe se mekanizmat ekzistues si MKR dhe plani vendor social krijojnë një bazë të mirë për të zgjeruar e thelluar shërbimet për grupet vulnerabël.

Në fushën e qeverisjes së mirë, të dhënat tregojnë rritje të **kapaciteteve njerëzore** (më shumë punonjës për 1,000 banorë dhe rritje e pjesëmarrjes në trajnime, sidomos për gratë dhe stafin e administratës), si dhe një nivel të qëndrueshëm **transparence**, me zhvillim të konsultimeve publike dhe publikim të raportit vjetor për transparencën. **Barazia gjinore** në përfaqësim është e stabilizuar, me një prani të qëndrueshme të grave në pozicione drejtuese dhe në këshillin bashkiak, duke krijuar bazë të mirë për hapa të tjerë cilësorë përpara. Në fushën e **integritit** në BE, ekzistenca e komisionit të integritit pranë këshillit bashkiak dhe përvoja në aplikimin për projekte europiane tregojnë angazhim, ndonëse mbetet hapësirë për rritjen e numrit të projekteve të fituara dhe forcimin e strukturave të brendshme të performancës dhe planifikimit tematik (migracion, diasporë, etj.).

Nga pikëpamja **financiare**, bashkia shënon një përmirësim të qartë të autonomisë fiskale dhe kapaciteteve të veta financiare: rriten ndjeshëm të ardhurat e veta për frymë, raporti i tyre ndaj transfertave dhe buxhetit, të ardhurat nga taksa e pasurisë, buxheti i miratuar për frymë dhe investimet për frymë. Kjo tregon progres në zgjerimin e bazës tatimore dhe në orientimin e burimeve drejt zhvillimit lokal, ndonëse nevojitet përmirësim në shkallën e përdorimit të të ardhurave dhe në balancën mes shpenzimeve të personelit, operacionale dhe investimeve.

Rekomandime

- Hartimi dhe miratimi i Planit Vendor të Arsimit Parauniversitar, për të krijuar një kornizë të qartë strategjike që orienton investimet, kapacitetet dhe politikat e përfshirjes.
- Zgjerimi i mbulimit në zonat rurale, duke synuar rritjen e mëtejshme të aksesit dhe përmirësimin e frekuencës së shërbimit.
- Investime në edukimin e komunitetit, për të reduktuar sasinë e mbetjeve të gjeneruara për banor dhe për të nxitur praktika më të mira të ndarjes dhe riciklimit.
- Të planifikohen investime të reja për zgjerimin e rrjetit të ujitjes dhe kullimit, në mënyrë që të rritet sipërfaqja e tokës bujqësore e mbuluar nga infrastruktura dhe të përmirësohet produktiviteti agrar.
- Të forcohet programi i mirëmbajtjes së kanaleve ekzistuese, duke u fokusuar në rritjen e funksionalitetit të tyre përtej përmirësimeve aktuale teknike, me qëllim rritjen e efikasitetit dhe reduktimin e humbjeve të ujit.
- Të hartohet dhe miratohet Plani Vendor i Integritetit, në mënyrë që bashkia të forcojë mekanizmat e transparencës, të parandalimit të korrupsionit dhe të rrisë besueshmërinë institucionale përmes standardeve të qarta etike dhe kontrollit të brendshëm.
- Të hartohet dhe të miratohet Plani Vendor i Veprimit për Barazinë Gjinore, në mënyrë që bashkia të krijojë një kuadër të qartë dhe të matshëm për promovimin e barazisë gjinore, fuqizimin e grave dhe vajzave dhe rritjen e përfaqësimit të tyre në proceset vendimmarrëse.

- Forcimi i kapaciteteve të stafit për hartimin e projekteve të BE-së do të mund të rriste cilësinë e aplikimeve dhe shkallën e projekteve të fituara.
- Aktivizimi i komisioneve të integritit evropian mund të kontribuojë në një monitorim më efektiv të mundësive të financimit dhe në përputhshmëri më të mirë me politikat e BE-së.
- Zhvillimi i marrëveshjeve ndërbashkiake do të ndihmonte në nxitjen e bashkëpunimeve horizontale dhe shkëmbimin e praktikave të mira mes bashkive.
- Hartimi i Planit të Migracionit dhe Diasporës do të sigurojë një qasje strategjike ndaj ndryshimeve demografike dhe angazhimit të diasporës në zhvillimin lokal.
- Ngritja dhe funksionalizimi i strukturës së performancës në nivel nominativ, në bashki do të përmirësonte monitorimin e rezultateve dhe cilësinë e vendimmarrjes së bazuar në evidencë.
- Të forcohet planifikimi dhe monitorimi i ekzekutimit buxhetor, me fokus në rritjen e efikasitetit të përdorimit të të ardhurave dhe balancimin e strukturës së shpenzimeve, në mënyrë që rritja e të ardhurave dhe e investimeve të shoqërohet me performancë më të qëndrueshme dhe përdorim optimal të burimeve financiare.